



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

**RAPORTI VJETOR 2018 I PROGRESIT TË IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË
SË REFORMËS SË MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE 2016-2018**

Prishtinë
Prill 2019

1.- PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
2.- PROGRESI I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	7
3.- INFORMIM I PËRGJITHSHËM MBI PROGRESIN E STRATEGJISË SIPAS FUSHAVE PRIORITARE, INDIKATORËVE DHE AKTIVITETEVE	10
<i>3.1.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 1: Disiplina fiskale</i>	13
3.1.1.- Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave	13
3.1.2.- Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve	14
3.1.3.- Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave	16
<i>3.2.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 2: Efektiviteti Alokues</i>	19
3.2.1.- Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)	19
3.2.2.- Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor	21
3.2.3.- Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital	22
<i>3.3.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 3: Efikasiteti operacional</i>	24
3.3.1.- Prioriteti 7: Prokurimi Publik	24
3.3.2.- Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm	25
3.3.3.- Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm	27
<i>3.4. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 4: Çështjet e ndërlidhura me MFP</i>	29
3.4.1.- Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI	29
3.4.2.- Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin	30
3.4.3.- Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP	31
4. VEPRIMET PRIORITARE PËR VITIN E ARDHSHËM BAZUAR NË SFIDAT E IDENTIFIKUARA DHE REKOMANDIMET PËR TEJKALIMIN E SFIDAVE	32

Shkurtesat

AB - Auditimi i Brendshëm
ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
BE - Bashkimi Evropian
BDMS (Budget Development and Management System) - Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
COSO (Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission) - Komiteti i Sponsorimit të Organizatave të Komisionit Treadway
DK - Dogana e Kosovës
DMR - Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDPS - Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik
IPSAS (International Public Sector Accounting Standards) - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
KBF - Komisioni për Buxhet dhe Financa
KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KE - Komisioni Evropian
KIP - Komiteti për Investime Publike
KBFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
KMFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik
LPP - Ligji për Prokurimin Publik
LMFPP - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF - Ministria e Financave
MFP - Menaxhimi i Financave Publike
MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OB - Organizatat Buxhetore
PEFA (Public Expenditure and Financial Accountability) - Llogaridhënia Financiare dhe e Shpenzimeve Publike
PIFC (Public Internal Financial Control) - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
PIP - Programi i Investimeve Publike
PVF - Pasqyra Vjetore Financiare
PPF – Project Preparation Facility
SBS (Sector Budget Support) - Përkrahja Buxhetore Sektoriale
SIGMA (Support for Improvement in Governance and Management - Përkrahje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhment)
SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SNAO – Zyra Kombëtare Suedeze e auditimit (Swedish National Audit Office)
SRMFP - Strategjia për Reformën e MFP
TI - Teknologjia Informative
ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZPS - Zyra për Planifikim Strategjik
ZKM - Zyra e Kryeministrit

Shënim: [Ky Raport vjetor për vitin 2018 është hartuar nga Grupi për Koordinim të Implementimit të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike në Republikën e Kosovës dhe pas konsultimeve me akterët relevant dhe Kabinetin e Ministrisë të Financave është prezantuar dhe aprovuar në Këshillin Ministror për Reformën e Administratës Publike si dhe është diskutuar në Takimin e Dialogut më 21 Maj 2019.](#)

1.- Përmbledhja ekzekutive

Ky raport i tretë vjetor përmbledh dhe paraqet arritjet e prioriteteve dhe progresin në aktivitete të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) gjatë vitit 2018. Hartimi i raportit monitorues vjetor ka për qëllim shqyrtimin e progresit të arritur në zbatimin e strategjisë si dhe identifikimin e sfidave. Sipas mandatit të dhënë me Vendimin e Ministrit, Nr. 33/2018, Grupi Koordinues për MFP në Dhjetor 2018 ka përfunduar rishikimin e Planit të Veprimit për vitin 2019-2020, i cili ka kaluar përmes konsultimit publik dhe diskutimit në Takimin e Dialogut për MFP. Masat korrigjuese janë vendosur në SRMFP 2019-2020, si shtesë, duke ruajtur strukturën ekzistuese të Shtyllave dhe Prioriteteve. Masat e reja të parapara në Planin e rishikuar janë kostuar.


Qasja e adoptuar në përgatitjen e Raportit vjetor ka qenë një kombinim i takimeve dhe konsultimeve brenda GK për MFP në mes të bartësve kryesorë të secilit prioritet, të vazhduar me konsultime me palët e interesit nën mbështetjen e SIGMA. Fillimisht është përgatitur tabela raportuese, e cila është plotësuar me kontributet nga bartësit kryesorë të prioriteteve. Kjo ka shërbyer si bazë për hartimin e Raportit narrativ vjetor 2018. Raporti është bazuar në planin e veprimit dhe pasaportën e indikatorëve, duke raportuar në nivel të indikatorëve.

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP), është ndërtuar mbi **4 shtylla, 12 prioritete dhe 23 indikatorë**, që përfshijnë gjithsej **66 aktivitete** në të gjitha fushat e reformës së Menaxhimit të Financave Publike. Raporti i tretë vjetor i zbatimit të Strategjisë për Reformën e MFP **evidenton progres të kënaqshëm** të arritur në shumicën e shtyllave.

Bazuar në raportet e pranuar nga strukturat përgjegjëse, nga gjashtëdhjetë e gjashtë (66) aktivitetet e planifikuara, raportohet se shumica e aktiviteteve të parapara për këtë vit janë zbatuar:


- **Tridhjetë e nëntë (39) aktivitete apo 59%** prej tyre, janë zbatuar në përputhje me planin e veprimit,
- **Dhjetë (10) aktivitete apo 15%** prej tyre janë zbatuar pjesërisht, dhe
- **Shtatëmbëdhjetë (17) aktivitete apo 26 %** prej tyre, nuk janë zbatuar me kohë apo janë evidentuar vonesa në fillim të zbatimit.

Grafiku 1. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të SRMFP-së, 2018




Grafiku në vijim paraqet progresin e zbatimit të prioriteteve të SRMFP për vitin 2018, bazuar në aktivitetet e parapara për vitin 2018.

Grafiku 2 Progresi i zbatimit të prioriteteve sipas aktiviteteve




Ndërsa analizuar në aspekt të katër shtyllave kryesore të strategjisë, raportohet që gjatë vitit 2018, numri më i madh i aktiviteteve të zbatuara i takon Shtyllës së parë: Disiplina Fiskale, me gjithsej **17 aktivitete të zbatuara**; pasuar nga Shtylla e tretë: Efikasiteti Operacional me gjithsej **12 aktivitete të zbatuara**. Grafiku më poshtë, prezanton të arriturat në zbatimin e aktiviteteve sipas shtyllave kryesore:

Grafiku 3. Progresi në shtyllat e SRMFP, sipas aktiviteteve, 2018



Grafiku në vijim paraqet arritjen e caqeve të synuara të indikatorëve për vitin 2018. Raporti vlerëson se janë arritur plotësisht 11 apo 48% e caqeve të synuara të indikatorëve për vitin 2018. Pjesërisht të arritur janë 3 apo 13% të caqeve të synuara, ndërsa 10 apo 39% e caqeve tjera të synuara për vitin 2018 nuk janë arritur në tërësi apo janë afër caktut.

Grafiku 4. Progresi i zbatimit të SRMFP-së sipas caqeve të indikatorëve për vitin 2018



Sfidat dhe aktivitetet e ardhshme

Duhet cekur, se me rastin e vlerësimit të indikatorëve, disa nga indikatorët nuk janë më relevant për reformën në fushën e MFP-së për shkak të ndryshimit të orientimit strategjik, ndërsa disa caqe tjera të përcaktuara nuk janë arritur në mungesë të mbështetjes financiare. Sfidat e identifikuar në Raport janë adresuar përmes masave korrigjuese me rastin e rishikimit të Planit të Veprimit 2019-2020. Rishikimi ka kaluar përmes diskutimit publik si dhe diskutimit në Takimin e Dialogut për MFP. Komentet e pranuar janë analizuar dhe adresuar përmes masave korrigjuese në Planin e rishikuar për vitet 2019-2020.

Sfida e evidentuar në shtyllën e parë tek prioriteti i dytë “Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollat e aplikueshme të zotimeve” është analizuar dhe janë ndërmarrë disa masa korrigjuese. Mos rishikimi i rregullores financiare për raportimin e vonesave tashmë është adresuar në Planin e veprimit të rishikuar. Vlen të theksohet se Ligji mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (KBFP) është miratuar dhe ka hyrë në fuqi nga Maji 2018. Në vitin 2019 pritet të aprovohet legjislacionit sekondar i këtij ligji, me çka pritet të vendoset një linjë më e qartë e përgjegjësisë dhe llogaridhënies brenda OB-ve, që do të ofrojnë kontroll efektiv mbi resurset publike dhe politikat zbatuese publike.

Tek shtylla e tretë, Prioriteti i nëntë “Fuqizimi i auditimit të jashtëm” indikatorët janë vlerësuar si sfidues për tu arritur. Faktikisht, krahasuar me vitin bazë dhe raportimin në vitin 2017, vërehet përmirësim i dukshëm dhe trend pozitiv sidomos në aktivitetet e ndërlidhura me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me rishikim të Planit të veprimit janë riformuluar indikatorët me qëllim që të jenë sa më realistik por ende sfidues. Janë paraparë masa korrigjuese si: - Komunikimi me Komisionet e Kuvendit me qëllim të koordinimit më të mirë për trajtimin e Raporteve të Auditimit (Komunikimi i vazhdueshëm) dhe - Përkrahja e Komisioneve të Kuvendit për rritjen e numrit e trajtimeve të Raporteve të auditimit në Kuvend dhe rritjen e shkallës së rekomandimeve të adresuara, përkatësisht zvogëlimin e shkallës së rekomandimeve të pa adresuara.

Si sfidë e vazhdueshme në kuadër të shtyllës së katërt kemi Prioritetin e dymbëdhjetë “Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP”. Vonesa e Mbështetjes Buxhetore Sektoriale ka pamundësuar realizimin e indikatorëve të këtij Prioriteti. Përkundër faktit se në vazhdimësi janë ndërmarr iniciativa për sigurimin e fondeve (GIZ, EUO, WB etj.), ato nuk kanë rezultuar me sigurimin e mjeteve për zbatimin e Studimit të Fizibilitetit. Vlen të theksohet se me buxhetin e vitit 2019 janë ndërmarr masa korrigjuese, janë ndarë mjetet buxhetore për realizimin e Studimit të fizibilitetit, pa përfshirë Zhvillimin e Kurrikulës. Pritet që gjatë vitit 2019 të zhvillohet studimi.


2.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Strategjisë

Në vijim paraqitet progresi në zbatimin e strategjisë sipas shtyllave, bazuar në arritjen e caqeve të indikatorëve për vitin 2018.

Shtylla I: Disiplina Fiskale

Për vitin 2018 mund të raportohet për zbatim të kënaqshëm në shtyllën e **Disiplinës Fiskale** kundrejt caqeve të dhëna në strategji. Shtylla e Disiplinës Fiskale, përshinë tre objektiva që ndërlidhen me avancimin e parashikimeve makroekonomike, zvogëlimin e vonesave në pagesa dhe zgjerimin e bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal. Kjo shtyllë gjithsejtë përmban gjashtë (6) indikatorë.

Grafiku 5. Shtylla I. Disiplina Fiskale, progresi sipas indikatorëve



Tek prioriteti i parë është ruajtur dhe përmirësuar saktësia e parashikimit të Indikatorëve makroekonomik dhe të të hyrave. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave të rregullta në krahasim me të hyrat e realizuara për vitin 2018 është -2.7%, që siguron trendin pozitiv drejt vlerës së synuar për vitin 2018 dhe cakun në 2020.


Për sa i përket prioritetit të dytë, kontrollet efektive të zotimeve, indikatorit i Borxheve të pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin 2018 raportohet të jetë 3.9%.

Përmirësim ka edhe në Prioritetin e tretë, në të tre indikatorët e ATK-së. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH dhe Shkalla e mbledhjes së borxheve kanë tejkaluar caqet e përcaktuara për vitin 2018. Ndërsa indikatorit që bën matjen e Numrit të tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare, është nën cakun e synuar për vitin 2018, mirëpo ka shënuar rritje krahasuar me bazën dhe krahasuar me vlerën e arritur në vitin 2017.

Shtylla II: Efikasiteti Alokues

Në shtyllën e **Efikasitetit Alokues**, e matur me caqet e vëna në SRMFP, paraqitet një pasqyrë e përzier për sa i përket progresit. Kjo Shtyllë përshinë tre prioritete që ndërlidhen me avancimin e mëtejshëm të rolit të KASH-it si dokument planifikues, fuqizimin e besueshmërisë në buxhetin vjetor si dhe menaxhimin më efikas dhe më efektiv të investimeve publike. Kjo shtyllë gjithsejtë përmban gjashtë (6) indikatorë.

Grafiku 6. Shtylla II. Efikasiteti Alokues, progresi sipas indikatorëve



Tek Prioriteti numër katër kanë vazhduar veprimet për zhvillimin e kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) përmes avancimit të mëtejshëm të rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit. Megjithatë, ndryshimet në orientimet strategjike për shkak të ndryshimeve politike janë reflektuar në numrat buxhetor dhe në KASH. Edhe gjatë vitit 2018 raportohet për shmangie në mes të kufirit të shpenzimeve në KASH dhe Buxhetit të aprovuar në Kuvend për vitin 2018. Kjo ka rezultuar që përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të të jetë 8.92% krahasuar me vitin bazë kur ishte 7.5%. Megjithatë, kjo shmangie është më e ulët krahasuar me vitin 2017 kur ishte mbi 22%.

Te prioriteti i pestë, indikatori që ka të bëjë me besueshmërinë dhe kontrollin e ekzekutimit të buxhetit vjetor e ka ruajtur përgjithësisht trendin e kufijve të pranueshëm. Në vazhdimësi prej vitit në vit ka pasur zvogëlim të numrit të transfereve, ku gjatë vitit fiskal 2018 janë bërë 78 transfere, që ka tejkaluar vitin 2018. Ndërsa, indikatori i dytë, ka shënuar shmangie në ekzekutim të përgjithshëm të buxhetit, krahasuar me buxhetin e aprovuar për 12.24 %, që është më shumë se në vitin 2016 dhe vitin bazë kur ishte 10.46%.

Te prioriteti i gjashtë, indikatori që lidhet me menaxhimin më efektiv dhe efikas të planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike, shënon progres për sa i përket numrit të rialokimeve për OB-të e nivelit qendror. Në vitin 2018 numri i ri-alokimeve ishte vetëm 21 krahasuar me 65 sa ishte numri i vitit bazë dhe ka arritur më lartë se vlera e synuar për vitin 2018. Ky është si rezultat i planifikimit më të saktë buxhetor dhe bashkëpunimit me OB-të. Ndërsa indikatori i dytë, përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal, është nën cakun për vitin 2018.

Shtylla III. Efikasiteti operacional

Shtylla e “**Efikasitetit Operacional**” përfshinë tre prioritete që ndërlidhen me përmirësimin e fushës së prokurimit publik, avancimin e auditimit dhe kontrollit të brendshëm si dhe avancimin e auditimit të jashtëm. Kjo shtyllë gjithsejtë përmban shtatë (7) indikatorëve.

Grafiku 7. Shtylla III. Efikasiteti Operacional, progresi sipas indikatorëve



Në prioritetin e shtatë Prokurimin Publik, është arritur progres në realizimin e parimit “vlera për para” përmes zvogëlimit në 8,18% të përqindjes së përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim. Ky indikator ka shënuar përmirësim krahasuar edhe me vlerën e raportuar në vitin 2017. Ndërsa indikatorin e dytë që matë përqindjen e monitorimit të njoftimeve për kontratë, mbetet nën vlerën e synuar për vitin 2018. Megjithatë vlen të theksohet që ky indikator ka shënuar një progres të konsiderueshëm nëse krahasohet me bazën prej 5%.


Në prioritetin e tetë, është arritur fuqizimi i mëtejshëm i auditimit të brendshëm përmes rritjes së numrit të auditorëve të brendshëm të certifikuar në 90.85%. Përqindja e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti për vitin 2018 është raportuar në takimin e Dialogut për MFP të jetë 51.24%.

Prioriteti i nëntë që ka të bëjë me fuqizimin e auditimit të jashtëm, përkundër përmbushjes së aktiviteteve, arritja e cagueve mbetet nën vlerat e synuara për vitin 2018. Kjo mos arritje e cagueve të indikatorëve për vitin 2018, ndërlidhet me specifikat e fushës së auditimit dhe mos adresimin e rekomandimeve të ZKA-së nga ana e OB-ve.

Shtylla IV. Çështjet e ndërlidhura me MFP

Shtylla e katërt, “Çështjet e ndërlidhura me MFP”, përfshinë tre prioritete që ndërlidhen me përmirësimin e sistemeve të TI, avancimin e raportimit në përputhje me standardin GFSM 2014 të FMN-së dhe ngritjen sistematike dhe të qëndrueshme të kapaciteteve të nëpunësve civil në MFP. Kjo shtyllë gjithsejtë përmban katër (4) indikatorë.

Grafiku 8. Shtylla IV. Çështjet e ndërlidhura me MFP



Për prioritetin e dhjetë që lidhet me përmirësimin e sistemeve të TI-së, raportohet se janë integruar në tërësi të 7 sistemet e TI -së, në mes të Ministrisë dhe Agjencive brenda MF-së.

Tek prioriteti i njëmbëdhjetë, janë zhvilluar një mori aktivitete në funksion të përmirësimit të sistemit të teknologjisë informative dhe proceseve që ndërlidhen me procesin buxhetor. Po ashtu është raportuar për avancim në raportim sipas standardeve SFQ (GFSM) 2014.

Për prioritetin e dymbëdhjetë, që adreson ngritjen e kapaciteteve në fushën e MFP në mënyrë sistematike, të qëndrueshme dhe të integruar, është raportuar për ngecje në zbatim. Arsyeja e ngecjes në zbatimin e studimit të fizibilitetit është mungesa e mjeteve financiare. Përfundimi i Studimit është parakusht për zbatimin e aktiviteteve të këtij prioriteti.

3.- Informim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë sipas fushave prioritare, indikatorëve dhe aktiviteteve

Në terma të përgjithshëm, Grupi Koordinues për Menaxhimin e Financave Publike (GKMFP) për vitin 2018 mund të raportojë se është arritur progres i kënaqshëm në zbatimin e indikatorëve dhe aktiviteteve të SMRFP-së për vitin 2018. Në vijim është tabela me vlerat relevante të indikatorëve për të katër shtyllat e SRMFP-së:

	Progres krahasuar me vlerën e synuar 2018
	Progres i pjesshëm krahasuar me vlerën e synuar 2018
	Nën vlerën e synuar 2018

Shtylla 1		Disiplina Fiskale					
Prioriteti 1	Indikator (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Një parashikim i kujdesshëm dhe real i të hyrave të rregullta të buxhetit dhe të hyrave të njëhershme.	1. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave në krahasim me ekzistueset.	(-7.7%)	5%	0 – 3 %	3.82%	-1.10%	-2.7%
	2. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave që ndodhin në buxhet vetëm një herë në krahasim me ekzistueset.	(-7.6%)	5%	4%	13.33%	-16.50%	NA
Prioriteti 2	Indikator (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve.	1. Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve.	3%	2%	1%	3.50%	4.20%	3.9%
Prioriteti 3	Indikator (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Zgjerimi i bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal dhe kontrabandimit të mallrave.	1. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH	16,583	21,75	35,000	24,653	20,708	25,806
	1. Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare.	62,886	73,117	100,000	62,347	66,767	68,835
	2. Shkalla e mbledhjes së borxheve.	16%	18%	19%		25%	25%

Shtylla 2		Efikasiteti alokues					
Prioriteti 4	Indikator (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Avancimi i mëtejshmë i rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme.	1. Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.	7.15%	6.50%	3.50%	3.52% (7.66%)*	22.03%	8.92%
	2. Numri i zyrtarëve të trajnuar për vlerësimin e ndikimit buxhetor-VNB.	80	90	120	40+40	90	120

* Kjo sepse dy OB nuk kanë qenë të planifikuara me KASH (2016-2018) ndërsa janë pjesë e ligjit për ndarje buxhetore për vitin 2016 (RTK dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror). Pa këto dy OB % e shmangies është 3.52

Prioriteti 5	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe besueshmërisë së tij, përfshirë planifikimin në nivel të programeve, për të siguruar që hartimi i buxhetit është në përputhje me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë.	1.Përqindja e shmangies mesatare të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB të nivelit qendror.	10.46%	9.00%	5%	3.86%	11.42%	12.24%
	2.Nr. i transfereve gjatë vitit fiskal	199	170	100	188	149	78
Prioriteti 6	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Një menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP-it do të ndikoj në një planifikim të drejt të projekteve kapitale që duhet të jenë të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe me prioritetet e Qeverisë.	1. Numri i ri-alokimeve për OB të nivelit qendror.	65	55	25	56	33	21
	2. Përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal	98%	170	100%	86%	59%	72.5%

Shtylla 3: Efikasiteti operacional		Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Prioriteti 7	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Sigurimi i përdorimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike si dhe realizimi i parimit kryesor në prokurimin publik “vlera për para”.	1.Përqindja e përdorimit të Procedurës së Negociuar pa publikim.	12,98 %	10%	7%	11.76%	9.17%.	8.18%
	2.Përqindja e monitorimit të njoftimeve për kontratë.	5%	100%	100%	80%	70%	57%
Prioriteti 8	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës	1.Përqindja e auditorëve të brendshëm të certifikuar	50%	80%	90%	65.33%	85.00%	90.85%
	2.Përqindja e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti.	51%	65%	65%	54.70%	48.59%	51.24%.
Prioriteti 9	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në	1. Përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.	10%	30%	50%	14.14%	12.5%	22%

përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranuar ndërkombëtarisht.	2.Përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit	32%	45%	60%		26%	34%
	3.Përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit	37%	25%	20%		38%	40%

Shtylla 4: Çështjet e ndërlidhura të MFP							
Prioriteti 10	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Përmirësimi i sistemeve të TI që funksionojnë në Ministrinë e Financave për ta përmirësuar cilësinë e informatave financiare.	1.Numri i sistemeve të Integruara	0	5	7	0	Duke u bërë përzgjedhja e OE për Integrim të sistemeve	7 sisteme
Prioriteti 11	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Sigurimi i pajtueshmërisë së informatave për buxhetin e Kosovës me FMN standardin GFS 2014.	1.Buxhetimi dhe raportimi sipas tabelës së llogaritjeve që është në pajtim me GFS 2014	Ka filluar publikimi	Planifikimi Buxhetor sipas GFS 2014	Standardi GFS 2014 në përdorim	Përgatitjet në vijim	Pritet rishikimi i Rregullës financiare për Planin Kontabël të harmonizuar me GFSM dhe IPSAS.	Planifikimi Buxhetor sipas GFS 2014
Prioriteti 12	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Arritja e një mënyrë sistematike, e qëndrueshme dhe e integruar e ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë në Menaxhimin e Financave Publike duke e shfrytëzuar ekspertizën vendore, të administratës publike dhe atë të jashtme.	1.Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP				Përgatitjet në vijim	Ngritja e kapaciteteve si më parë	
	2. Numri i zyrtarëve të trajnuar në fushën e MFP				Përgatitjet në vijim	Ngritja e kapaciteteve si më parë	

3.1.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 1: Disiplina fiskale

Në shtyllën e parë të SRMFP Disiplina Fiskale janë 3 Prioritete. Në këtë seksion po e prezantojmë progresin në drejtim të arritjes së objektivit dhe aktiviteteve të ndërlidhura për çdo prioritet në këtë shtyllë për vitin 2018.

3.1.1.- Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave

Prioriteti i parë i SRMFP, i referohet avancimit të saktësisë së parashikimit të indikatorëve makroekonomik, përfshirë parashikimin e të hyrave, si bazë e përcaktimit të hapësirës fiskale për financim të politikave publike të Qeverisë. Institucioni përgjegjës për arritje të këtij prioriteti është Ministria e Financave – Departamenti për Politika Ekonomike dhe bashkëpunim ndërkombëtar financiar. Arritja e këtij prioriteti përmirëson cilësinë e informatave të nevojshme për vendim-marrësit politik si dhe do të krijojë një bazë të shëndoshë për bashkëpunim efektiv me partnerët financiar ndërkombëtar, duke i kontribuar ruajtjes së stabilitetit makroekonomik si një prej synimeve afat-gjatë të Menaxhimit të Financave Publike.

Parashikimi i besueshëm dhe real i të hyrave tatimore është një nga fushat prioritare të reformës. Në indikatorin e parë, shmangia mesatare e parashikimit të hyrave tatimore në krahasim me të hyrat tatimore të realizuara bazuar në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës, për vitin 2018, është -2.7%, që tregon arritjen e caktuar për vitin 2018 si dhe për vazhdimin e trendit për arritjen e caktuar në vitin 2020. Indikatorin është llogaritur sipas formulës së përcaktuar në Pasaportën e Indikatorëve.


Ndërsa sa i përket indikatorit të dytë, që ndërlidhet me shmangien mesatare të realizimit të hyrave të njëhershme krahasuar me parashikimet, në vitin 2018 janë planifikuar që të mbledhen të hyra në vlerë prej 8 milion €. Në raportin financiar për vitin 2018, nuk raportohet të ketë pasur të hyra të njëhershme si zë i veçantë buxhetor, kjo pasi që të hyrat e njëhershme të planifikuara për vitin janë raportuar brenda kategorive përkatëse të tatimeve. Si i tillë numerikisht, matja e saktë e këtij indikator nuk është i mundur. Ajo që vlen të theksohet është fakti që nga viti 2015 e tutje, planifikimi i të hyrave të njëhershme në buxhet ka shënuar rënie të vazhdueshme duke shënuar përmirësim në planifikim të të hyrave brenda kategorive përkatëse. Si rezultat, në Buxhetin për vitin 2019, të gjitha të hyrat buxhetore janë planifikuar brenda kategorive përkatëse të të hyrave.

Objektivi 1	Indikatorin (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllim i 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Një parashikimi i kujdesshëm dhe real i të hyrave të rregullta të buxhetit dhe të hyrave të njëhershme.	1. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave në krahasim me ekzistueset.	(-7.7%)	5%	0 – 3 %	3.82%	-1.10%	-2.7%
	2. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave që ndodhin në buxhet vetëm një herë në krahasim me ekzistueset.	(-7.6%)	5%	4%	13.33%	-16.50%	NA

Komenti për statusin e aktiviteteve 1.1- 1.5

Në arritjen e këtij objektivi, janë paraparë 5 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatim të dy aktiviteteve 1.1 dhe 1.5, ndërsa është raportuar për vonesa në zbatim të aktiviteteve: 1.2, 1.3 dhe 1.4. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 9 Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave



- (1.1) Të siguruarit e kapacitetit të mjaftueshëm të stafit të trajnuar të njësisë së makroekonomikë.- gjatë vitit 2018 kanë vazhduar trajnimet për stafin në veçanti në modelimin e indikatorëve makroekonomik, analiza për qëndrueshmërinë e borxhit dhe projeksionin e të hyrave. Trajnimet janë mbajtur nga USAID, Banka Botërore si dhe projekti i Qeverisë së Luksemburgut “Lux Development”
- (1.2) Publikimi i metodologjisë së hartimit të parashikimeve ekonomike.-sa i takon këtij aktivitetit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e këtij aktiviteti. Planifikohet që gjatë vitit 2019 të bëhet publikimi i metodologjisë së parashikimeve në ueb faqen e MF-së.
- (1.3) Publikimi i kornizës makro-fiskale dhe indikatorëve ekonomik para miratimit të KASH dhe Ligjit të Buxhetit-edhe gjatë vitit 2018.- korniza makro fiskale është publikuar si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Ligjit të Buxhetit për vitin 2019. Gjatë tri viteve të kaluara edhe pse korniza makro-fiskale është përgatitur, nuk është publikuar me Ligjin e Buxhetit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.
- (1.4) Vendosija e pavarësisë së njësisë së makroekonomisë.- gjatë periudhës raportuese nuk është ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë aktivitet.
- (1.5) Nxjerrja e një rregulloreje që do ta kufizonte përfshirjen e të hyrave që ndodhin vetëm një herë.- gjatë periudhës raportuese nuk është ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë aktivitet. Duke pas parasysh që pjesa më e madhe e të hyrave të njehershme për vitin 2018 ishte planifikuar të realizohej nga zbatimi i Ligjit për faljen e borxheve, dhe duke pas parasysh që ligji ishte në fuqi deri më 31 gusht 2017, ky aktivitet vlerësohet si i arritur. Si rezultat, në buxhetin e vitit 2019 nuk janë planifikuar të hyrat e njehershme.

3.1.2.- Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve

Qëllimi i këtij prioriteti janë kontrollet efektive të zotimeve, ku synohet të arrihet duke menaxhuar më mirë vonesat e pagesave përmes kontrolleve financiare në zotime. Institucionet kryesore përgjegjëse për arritje të këtij prioriteti janë Thesari dhe Njësia Qendrore Harmonizuese (NJQH).

Gjatë vitit 2018, është raportuar të jetë shënuar progres i pjesshëm në zbatimin e aktiviteteve drejt realizimit të prioritetit nr.2, gjegjësisht objektivit për Zvogëlimin e vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve. Brenda kësaj periudhe është raportuar të jetë miratuar dhe hyrë në fuqi Ligji mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (KBFP) si dhe është hartuar draft rregullorja për menaxhim financiar dhe kontroll. Përmes zbatimit të ligjit dhe akteve tjera sekondare legislative, pritet të vendoset një linjë më e qartë e përgjegjësisë dhe llogaridhënies brenda OB-ve, që do të ofrojnë kontroll efektiv mbi resurset publike dhe politikat zbatuese publike.

Ky prioritet, po ashtu bazohet edhe në disa aktivitete që mbulojnë forcimin e funksionit të auditimit të brendshëm të matura me Certifikimin e Auditorëve të Brendshëm, zhvillimin e mëtejshëm të stafit të NJQH dhe veprimet që kanë të bëjnë me librin e proceseve. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2018, është raportuar për trajnim të zyrtarëve përgjegjës në fushën e menaxhimit të rrezikut, ku kanë marrë pjesë 120 pjesëmarrës nga OB të ndryshme. Gjithashtu, në përputhje me planin e veprimit, në bashkëpunim me USAID është hartuar Libri për përshkrimin e proceseve.


Është raportuar për vonesa në rishikimin e rregullores financiare për raportimin e vonesave në pagesa. Si rezultat nuk janë realizuar as sanksionimet e planifikuara me planin e veprimit për vitin 2018. Si pasojë e mos veprimit konkret, borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve janë rritur krahasuar me vitin bazë, nga 3.4% në 3.9%.

Objektivi 2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllim i 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve.	1. Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve.	3%	2%	1%	3.50%	4.20%	3.9%

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 2.1-2.10

Për arritjen e këtij Objektivit, janë paraparë 10 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018, është evidentuar progres në zbatim tek pothuajse gjysma e aktiviteteve, siç janë aktivitetet: 2.2; 2.4; 2.7; 2.9 dhe 2.10. Pjesërisht është zbatuar aktiviteti 2.5. Ndërsa është raportuar për vonesa në zbatim në aktivitetet: 2.1, 2.3, 2.6, 2.8. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 10 Prioriteti 2: Kontrollet efektive të zotimeve



- (2.1) Ndryshimet në LMFPP/Rregullore.- gjatë vitit 2018, draft rregullorja për menaxhim financiar e kontroll është kryer nga grupi punues dhe është dorëzuar në zyrën ligjore për

procedura të mëtutjeshme, por nuk është aprovuar ende. Janë organizuar edhe trajnime për Llogaridhënie menaxheriale si dhe është bërë plotësimi i pyetësorëve vetë vlerësues nga të gjithë zyrtarët përgjegjës të OB.

- (2.2) Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të zyrtarit (-ëve) financiar.- janë trajnuar 120 zyrtarë përgjegjës për menaxhimin e rrezikut në OB.
- (2.3) Futja në përdorim e kontabilitetit të keshit të modifikuar dhe raportimit.- nuk ka progres në zbatim të këtij aktiviteti, ku ende nuk është hartuar UA që krijon bazën ligjore për futjen në përdorim të kontabilitetit të keshit të modifikuar.
- (2.4) Identifikimi dhe krijimi i kontrolleve.- Libri i përshkrimit të proceseve është miratuar nga MF u është dërguar të gjitha organizatave buxhetore dhe janë trajnuar të gjithë zyrtarët përgjegjës për këtë. Libri për përshkrimin e proceseve është i publikuar në ueb faqen e MF.
- (2.5) Zgjerimi i funksioneve të SIMFK.- gjatë vitit 2018 është bërë shpallja e tenderit dhe përzgjedhja e kompanisë për ngritje të SIMFK-së. Gjatë vitit 2018 është bërë integrimi i pjesshëm i Arkivës elektronike në SIMFK për disa module (Urdhër blerjes dhe Shpenzimeve).
- (2.6) Rishikimi i rregullores financiare për raportimin e vonesave në pagesa.- Thesari gjatë vitit 2018 ka analizuar dhe përcjellur trendet bazuar në rregulloren aktuale, ndërsa ka pasur ngecje në rishikimin e rregullores ashtu siç është paraparë me planin e aktiviteteve.
- (2.7) Raportimi i borxheve të brendshme nga Njësia e borxheve.- në bazë të fushave të përgjegjësisë në Thesar këtë aktivitet e ka zbatuar Njësia e Monitorimit të OB-ve dhe ndërlidhet me avancimet që do bëhen në vitin 2019 tek aktiviteti 2.6.
- (2.8) Sanksionimi i organizatave buxhetore në rastet e vonesës në pagesa.- nuk ka pasur sanksionim pasi që rregullorja do nxirret në vitin 2019.
- (2.9) Monitorimin e OB-ve përmes SIMFK-së dhe arkivës elektronike.- gjatë vitit 2018 Njësia për Monitorim ka monitoruar në vazhdimësi dhe ka dërguar vërejtje tek OB-të për zbatimin e afateve kohore në aprovimin e shpenzimeve në SIMFK dhe zbatimin e planit kontabël.
- (2.10) Ngritja e kapaciteteve tek Njësia për Monitorim (NJpM).- në tetor të vitit 2018 Thesari ka mbajtur seminar/takim me të gjithë ZKF-të e OB-ve lidhur me monitorimin e zbatimit të rregullave financiare.

3.1.3.- Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave

Sistemi aktual i menaxhimit të financave publike në Kosovë e mbështet disiplinën e përgjithshme fiskale. Për ta mbajtur qëndrueshmërinë në disiplinën fiskale është e nevojshme kalimi i mbledhjes së të hyrave nga kufiri brenda vendit, që do të ndikojë në financimin e investimeve publike të nevojshme për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për t'i adresuar sfidat e shumta.

Sa i përket objektivës - Zgjerimi i bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal dhe kontrabandimit të mallrave, gjatë vitit 2018 indikator i parë, që ndërlidhet me numrin e përgjithshëm të tatimpaguesve të regjistruar, është arritur caku. Tatim paguesit aktiv të regjistruar në TVSH, arriti numri në 25,806 tatimpagues që krahasuar me pikën referuese është tejkalim prej 18% ose 4,631 tatimpagues më shumë.

Sa i përket indikatorit të dytë, që lidhet me numrin e përgjithshëm të tatim paguesve që deklarojnë të ardhura në mënyrë vullnetare, përfshirë këtu biznese dhe persona fizik në fund të vitit numri ishte 68,835 deklarues ndërsa caku ishte 73.117. Duke marrë për bazë pikën referuese shihet se ky indikator nuk ka arritur cakun e përcaktuar. Përkundër kësaj, vlen të ceket se numri deklaruesve është në rritje të vazhdueshme dhe ka trend pozitiv. Kjo rritje është

realizuar falë intensifikimit të aktiviteteve në terren dhe monitorimit sa më afër të mos-deklaruesve.

Sa i përket përmirësimit dhe avancimit lidhur me deklaruesit tatimpagues, në vitin 2018 ka filluar aktiviteti i pastrimit të regjistrit të tatimpaguesve, i cili pritet të ketë efekt në rritjen e numrit të deklaruesve gjatë viteve në vijim.

Për sa i përket indikatorit të tretë lidhur me shkallën e mbledhjes së borxhit, gjatë vitit 2018 shuma e borxhit të inkasuar ishte 77,341,543 euro, kurse borxhi i mbetur i mbledhshëm më datën 31.12.2018 ka qenë 309,047,002 euro. Nëse krahasojmë me përqindjen e cila ka qenë e synuar për vitin 2018, që ishte 18% atëherë shihet se shuma e inkasuar është me pjesëmarrje prej 25% në shumën totale të borxhit të mbledhshëm dhe kjo tregon se kemi një tejkalim të caktuar prej 7%. Lidhur me zbatimin e këtij indikator, është zhvilluar Plani Operativ vjetor, i cili përmban aktivitetet dhe afatet e trajtimit të borxhit tatimor. Në këtë plan, janë të përfshira borxhet të cilat ATK ka kompetencë ligjore në mbledhjen e tyre, pra borxhet e mbledhshme.


Gjithashtu, është raportuar për progres të kënaqshëm edhe në aktivitetet që janë pjesë e kompetencave të Doganës të Kosovës, e që ndërlidhen më zhvillimin e kapacitetit të zyrtarëve doganorë në fushat e origjinës dhe vlerësimit të mallit. Modernizimi i mëtutjeshëm i Administratës Doganore është në proces, duke u fokusuar në disa fusha të rëndësishme. Modernizimi përfshinë menaxhimin e riskut dhe fuqizimin e masave kundër kontrabandës, duke bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Kosovës.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raport i 2017	Raporti 2018
Zgjerimi i bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal dhe kontrabandimit të mallrave.	Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH	16,583	21,75	35,000	24,653	20,708	25,806
	Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare.	62,886	73,117	100,000	62,347	66,767	68,835
	Shkalla e mbledhjes së borxheve.	16%	18%	19%		25%	25%

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitete 3.1.-3.12

Për arritjen e këtij Objektivi, janë paraparë 12 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatim tek 10 aktivitete siç janë aktivitetet: 3.1, 3.4-3.12. Pjesërisht është zbatuar aktiviteti 3.2 dhe 3.3. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 11 Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave



- (3.1) Themelimi i Agjencisë së Tatimeve dhe Doganave të Kosovës (ATDK).- me rekomandim të FMN dhe partnerëve ndërkombëtar është vendosur që mos të vazhdohet me themelim të Agjencisë së re ATDK, por do të ketë bashkim vetëm të disa funksioneve të përbashkëta brenda ATK-DK që qojnë drejt rritjes së efikasitetit të mbledhjes së të hyrave. Për shkak të ndryshimit të orientimit strategjik ky aktivitet nuk është përfshirë në rishikimin e Planit të Veprimit të SRMFP 2019-2020.
- (3.2) Lidhur me zhvillimin e sistemit për faturën elektronike.- me hartimin e kërkesave të shfrytëzuesit për sistemin e ri të TIK, është vlerësuar se është komponentë e Sistemit të ri të TIK dhe si e tillë do të funksionalizohet me sistemin e ri të TIK.
- (3.3) Zhvillimi i Sistemit të Ri të teknologjisë informative.- gjatë periudhës raportuese komisioni vlerësues ka bërë analizimin e dosjeve të tenderit dhe tani është në pritje të procesit për përzgjedhjen e ofertës dhe kontraktimit të suksesshëm të Operatorit Ekonomik. Aktualisht komisioni i vlerësimit është në fazën e fundit të vlerësimit të zgjidhjeve të ofertuara. Si rrjedhojë, kemi vonesë në zbatim të këtij aktiviteti, për shkak të procesit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomik.
- (3.4) Gjatë vitit 2018, është realizuar ekspertiza nga FMN me temë, përmirësimi i menaxhimit të rrezikut të përmbushjes. Gjatë kësaj ekspertize janë analizuar mundësitë e ngritjes së efikasitetit të Menaxhimit të Rrezikut të Përmbushjes dhe nga eksperti janë ndarë praktikat e mira ndërkombëtare të cilat mund të përshtaten në Kosovë. Përkrahja në ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë do të vazhdojë edhe për një vit.
- (3.5) - (3.12) Sa i përket aktiviteteve nga 3.5 deri në 3.12, Dogana e Kosovës gjatë vitit 2018 ka inkasuar në total 1,135,015,816.01 €, duke e tejkaluar kështu totalin e të hyrave të inkasuara gjatë vitit 2017.
Stafi i Doganës përgjatë vitit 2018, ka ngritur kapacitetet administrative në fusha operative, duke ndjekur trajnime për zbatimin e teknikave të reja në zbulimin e kontrabandës së mallrave. Përgjatë periudhës raportuese, gjithashtu ka pasur trajnime edhe nga fushat e Origjinës dhe vlerësimit. Dogana e Kosovës shfrytëzon analizën e riskut për të krijuar profile të reja dhe për të rifreskuar profilet aktuale, kjo me qëllim të targetimit të mallrave për të cilat dyshohet se nënvlerësohen dhe rrjedhimisht edhe gjatë vitit 2018 janë krijuar profile të reja me qëllim të adresimit të kësaj dukurie.
Gjatë këtij viti ka pasur aktivitete të shumta nga ekipet antikontrabandë duke u fokusuar në patrullimet në vendet me risk të lartë. Gjithashtu, Dogana ka pasur aktivitete të përbashkëta edhe me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, përfshirë këtu operacione të përbashkëta.

3.2.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 2: Efektiviteti Alokues

Në shtyllën e dytë të SRMFP, Efektiviteti Alokues, janë parapare 3 Prioritete. Në këtë seksion prezantohet progresi në drejtim të arritjes së objektivit dhe aktivitetëve të ndërlidhura për çdo prioritet në këtë shtyllë.

3.2.1.- Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)

Planifikimi afatmesëm i resurseve publike përmes KASH është një nga fushat prioritare të reformës. Vlerësimet për vitin 2018 tregojnë një ndërlidhje të mirë të strategjive kombëtare dhe proceseve buxhetore vjetore përmes avancimit të rolit të KASH si një instrument i planifikimit dhe ndarjes afatmesëm të buxhetit. Kanë vazhduar veprimet për zhvillimin e KASH përmes avancimit të mëtejme të rolit të tij si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit.

Për sa i përket Objektivës “Avancimi i mëtejme i rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme”, indikatori i parë Përqindja e shmangies mesatare në mes të kufirit të shpenzimeve në KASH 2018-2020 dhe Buxhetit të aprovuar në Kuvend për vitin 2018 është 8.92%. Ky indikator është nën cakun e përcaktuar për vitin 2018. Megjithatë, krahasuar me vitin 2017 indikatori ka shënuar trend pozitiv.

Kjo diferencë në mes të buxhetit të planifikuar me KASH 2018-2020 me buxhetin e aprovuar për vitin 2018, vjen si rezultat i këtyre ndryshimeve, të cilat kanë qenë të planifikuara me KASH dhe nuk kanë qenë në buxhet ose kanë qenë me shuma më të ulëta (për sqarim po i paraqesim vetëm disa ndryshime me shuma më të larta) si:

- Kontigjenca prej 55 mil €, e cila është paraparë për adresimin e rreziqeve fiskale e cila është planifikuar me KASH 2018-2020, këto mjete nuk kanë qenë në buxhetin e aprovuar për vitin 2018,
- Klauzola e Investimeve me KASH 2018-2020, ka qenë e paraparë në shumë prej 75.9 mil. € ndërsa me buxhet është aprovuar në shumë prej 62 mil.€,
- Shpenzimet e paparashikuara kanë qenë të planifikuara në KASH 2018-2020 në shumë prej 14.8 mil.€, ndërsa me buxhet është aprovuar shuma prej 4.8 mil.€,
- Brenda buxhetit të Ministrisë së Financave kanë qenë të planifikuara në KASH 2018-2020 kontigjenca në shumë prej 19.3 mil.€, ndërsa me buxhetin e aprovuar janë vetëm 3 mil. € kontigjenca, etj.


Sa i përket indikatorit të dytë, që lidhet me numrin e zyrtarëve të trajnuar/këshilluar për vlerësimin e ndikimit buxhetor (VNB), është shënuar progres pasi që janë ofruar trajnime për rreth 120 zyrtarë. Krahasuar me vitin 2017 janë rreth 30 zyrtarë më shumë të trajnuar dhe më këtë është kaluar edhe caku i synuar për vitin 2018.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Avancimi i mëtejshëm i rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme.	Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.	7.15 % ¹	6.5 %	3.5%	3.52 % (7.66 %)*	22.03 %	8.92%
	Numri i zyrtarëve të trajnuar për vlerësimin e ndikimit buxhetor-VNB.	80 ²	90	120	40+40	90	120

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 4.1.-4.5

Për arritjen e këtij Objektivit, janë paraparë 5 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatimin e katër aktiviteteve 4.1; 4.2; 4.4 dhe 4.5, ndërsa vonesa është evidentuar te aktiviteti 4.3. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 12 Prioriteti 4 Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)



- (4.1) Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) dhe i Komisionit për Planifikim Strategjik janë funksionalizuar, dhe shqyrtimi i dokumenteve është bërë me kohë.
- (4.2) Departamenti i Buxhetit ka ofruar këshillime të nevojshme profesionale për mbi 120 zyrtarë të OB-ve të nivelit Qendror, sipas kërkesave dhe nevojave që janë paraqitur nga OB-të.
- (4.3) Tabela e standardizuar për paraqitjen e shmangieve në kufijtë e KASH dhe ndarje buxhetore finale.- ky aktivitet nuk është realizuar.
- (4.4) Vlerësimi i rrezikut nga OB-të për planifikim të buxhetit.- në bashkëpunim me IKAP janë trajnuar 120 ZKF dhe ZF. Në bashkëpunim me USAID janë trajnuar rreth 150 zyrtarë të nivelit lokal dhe qendror.
- (4.5) Zbatimi i qasjes sektoriale gjatë përgatitjes së KASH- KASH 2019-2021 është përgatitur sipas qasjes sektoriale.

¹Vlera bazë i referohet vitit 2015

²Vlera bazë i referohet vitit 2015

3.2.2.- Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor

Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe përputhjes me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë, është një prioritet në vazhdimësi i SRMFP. Grupi Koordinues sipas të dhënave të pranura vlerëson se ka një trend të qëndrueshëm në fuqizimin e planifikimit buxhetor vjetor dhe konsistencës së ndërlidhjes së buxhetit vjetor me politikat strategjike publike dhe kornizën makro-fiskale.

Për vitin 2018 shmangia mesatare (%) e ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB-ve të nivelit qendror është 12.24%. Ky indikator është nën cakun e synuar për vitin 2018, kjo shmangie kryesisht vjen si rezultat i mosekzekutimit të projekteve kapitale nga mekanizmi i Klauzolës së investimeve si dhe transfereve sociale.

Sa i përket indikatorit të dytë, numrit të transfereve, prej vitit në vit ka pasur progres. Gjatë vitit fiskal 2018 janë bërë 78 transfere. Krahasuar me vitin 2017 kur ishin 149 transfere, siç shihet është arritur progres i madh. Ky rezultat për më shumë tejkalon edhe cakun e pritshmërisë për vitin 2020.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe besueshmërisë së tij, përfshirë planifikimin në nivel të programeve, për të siguruar që hartimi i buxhetit është në përputhje me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë.	1. Përqindja e shmangies mesatare të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB të nivelit qendror.	10.46% ³	9.0%	5%	3.86%	11.42%	12.24%
	2. Nr. i transfereve gjatë vitit fiskal	199 ⁴	170	100	188	149	78


Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 5.1-5.3

Për arritjen e këtij Objektivit, janë paraparë 3 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres i pjesshëm në aktivitetin 5.1, ndërsa vonesë në zbatimin e dy aktiviteteve 5.2 dhe 5.3. Për shkak, të ndryshimit të orientimit strategjik, me aprovimin e Planit të Veprimit të SRMFP të rishikuar 2019-2020, aktiviteti 5.2 është larguar ndërsa aktiviteti 5.3 është rishikuar. Të dy këto aktivitete nuk janë vlerësuar relevante për arritjen e objektivit. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

³Vlera bazë i referohet vitit 2015

⁴Vlera bazë i referohet vitit 2015

Grafiku 13 Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor



- (5.1) Përgatitja e Udhëzimit administrativ për transfere-rialokime.- ky aktivitet është realizuar pjesërisht. Grupi punues ka hartuar draft UA për transfere-rialokime por nuk ka filluar implementimi.
- (5.2) Buxhetimi i bazuar në Programe.- Implementimi i pilot projektit të buxhetimit bazuar në programe për Ministrinë e Financave dhe Trajnimi për zyrtarët e Departamentit të Buxhetit mbi buxhetimin bazuar në programe nuk janë realizuar.
- (5.3) Hartimi i planit strategjik për buxhetimin Programor.- nuk është realizuar.

3.2.3.- Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital

Ndërlidhja sistematike e projekteve kapitale me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe me politikat sektoriale, dhe cilësia e analizës teknike të projekteve është objektivi e Prioritetit 6 të SRMFP. Më konkretisht gjatë vitit 2018 është themeluar GP brenda MF për hartim të Udhëzimit Administrativ në bazë të së cilës do të përcaktohet metodologjia e vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve. Ngjashëm me këtë është themeluar po ashtu grupi tjetër punues për hartim të Udhëzimit Administrativ që e definojnë qartë se çka duhet të trajtohet projekt kapital. Të dy këto Udhëzime Administrative janë hartuar gjatë 2018, mirëpo asnjëra nga këto nuk është arritur të miratohet në Qeveri dhe të fillojë implementimin brenda vitit 2018 dhe si rezultat, shënohet ngecje në zbatim të tyre krahasuar me pikën e referimit për 2018.

Për sa i përket indikatorit të parë, ka trend përmirësimi (rënie) në numrin e ri-alokimeve për OB të nivelit qendror. Gjatë vitit 2018, numri i ri-alokimeve ishte vetëm 21 krahasuar me 65 sa ishte numri i vitit bazë. Ky Indikatorë ka tejkaluar vlerën e synuar si rezultat i planifikimit më të saktë buxhetor dhe bashkëpunimit me OB-të.


Indikatorit i dytë që ka të bëjë me përqindjen e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal, mbetet ende sfidë. Ky indikator është 72.5%, dukshëm më pak se synimi. Gjatë rishikimit të Planit të Veprimit të SRMFP 2019-2020 ky indikatorë është riformuluar.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Një menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP-it do të ndikoj në një planifikim të drejt të projekteve kapitale që duhet të jenë të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtarë për Zhvillim dhe me prioritetet e Qeverisë.	1. Numri i ri-alokimeve për OB të nivelit qendror.	65 ⁵	55	25	56	33	21
	2. Përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal	98% ⁶	99 %	100 %	86 %	59 % ⁷	72.5

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 6.1.-6.4

Për arritjen e këtij Objektivit, janë paraparë 4 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në dy aktivitete 6.2 dhe 6.4, ndërsa progres i pjesshëm në zbatimin e dy aktiviteteve 6.1 dhe 6.3. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 14 Prioriteti 6. Cilësia e informatave të buxhetit kapital



- (6.1) Miratimi i Rregullores.- nuk është realizuar fillimisht miratimi, prandaj kemi vonesë në zbatimin e këtij aktiviteti. Është hartuar draft UA dhe pritet që së shpejti të aprovohet dhe të fillon implementimi i tij.
- (6.2) Së paku 120 zyrtarë të OB-ve të nivelit qendror dhe lokal të trajnuar për sistem të PIP.- është realizuar ky aktivitet, janë trajnuar sipas kërkesave.
- (6.3) Nxjerrja e një Udhëzimit Administrativ për definimin e shpenzimeve kapitale.- është hartuar draft UA dhe pritet që së shpejti të aprovohet dhe të fillon implementimi i tij.
- (6.4) Mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemit PIP.- ky aktivitet është realizuar në sistemin e Teknologjisë Informative në MF.

⁵Vlera bazë i referohet vitit 2015

⁶ Vlera bazë i referohet vitit 2015

⁷ Mos realizim i shpenzimeve është si pasojë e mjeteve të AKP të paraqitura në BA dhe klauzola e investimeve

3.3.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 3: Efikasiteti operacional

Efikasiteti Operacional është adresuar përmes tre Prioriteteve në SRMFP. Në këtë shtyllë reformat fokusohen në buxhetin kapital, prokurimin, kontrollin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm. Në vijim do të prezantohen arritjet për prioritetet e shtyllës së tretë.

3.3.1.- Prioriteti 7: Prokurimi Publik

Në këtë objektivi të reformës së SRMFP, janë ndërmarrë veprime në ngritjen e kapaciteteve teknike, sistemore dhe njerëzore. Të gjitha këto kanë rezultuar me ruajtje të trendit në ngritje të garancive për sigurimin e përdorimit efikas dhe transparent të fondeve publike.

Sa i përket indikatorit të parë, pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2018 sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë është 8.18%. Vlera e synuar për vitin 2018, është arritur dhe evidenton një progres krahasuar me vitin 2017. Ky indikator ndikon pozitivisht drejt arritjes së caktuar për vitin 2020.

Tek indikatorit i dytë, gjatë vitit 2018 KRPP ka monitoruar 57% të njoftimeve për kontratë, që është nën cakun e paraparë për vitin 2018 (100%). Vlen të theksohet se ky indikator ka shënuar progres të kënaqshëm krahasuar me vlerën bazë të vitit 2016 (5%). Arsyeja e mos arritjes së caktuar lidhet me fokusimin në monitorimin e dokumentacionit tjetër tenderues dhe llojeve të tjera të njoftimeve sipas LPP.

Objektivi	Indikatorit (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Sigurimi i përdorimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike si dhe realizimi i parimit kryesor në prokurimin publik "vlera për para".	1. Përqindja e përdorimit të Procedurës së Negociuar pa publikim.	12,98 % ⁸	10%	7%	11.76 %	9.17%	8.18
	2. Përqindja e monitorimit të njoftimeve për kontratë.	5%	100 %	100%	80%	70%	57%

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 7.1-7.5

Për arritjen e këtij Objektivi, janë paraparë 5 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në tri aktivitete 7.1, 7.2 dhe 7.4, ndërsa progres i pjesshëm në zbatimin e aktivitetit 7.3, Ndërsa vonesa është evidentuar në aktivitetin 7.5. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 15 Prioriteti 7. Prokurimi Publik



⁸Vlera bazë i referohet vitit 2014. Për vitin 2015 vlera është 16.1%

- (7.1) Themelimi i sistemit të Prokurimit elektronik për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.- nga 01 Janari 2018, platforma e prokurimit elektronik është bërë e detyrueshme për të gjitha llojet e prokurimeve me vlerë mbi 1000 Euro, ose për 98% të të gjitha aktiviteteve të prokurimit që zbatohen nga Autoritetet Kontraktuese (AK) në nivel të vendit.
- (7.2) Zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve të centralizuara të prokurimit.- është shënuar progres edhe në zbatimin e prokurimit të centralizuar. AQP ka arritur që aktivitetet e veta të zhvilloj në përputhje me planin e vet dinamik dhe këto kanë rezultuar me kursime të konsiderueshme për Buxhetin e Kosovës që janë 7 deri në 12 % varësisht nga mallrat apo shërbimet e prokuruar. AQP të gjitha aktivitetet e prokurimit i zhvillon në platformën e Prokurimit elektronik (fully Elektronik) që nga Qershori i vitit 2018. Në përputhje me UA 06/2018 të gjitha aktivitetet e prokurimit janë tenderuar. Për 70% të prokurimeve janë nënshkruar kontratat, ndërsa 15% janë në fazë të tenderimit dhe 15 % janë në fazë të vlerësimit apo ankimimit. Sa i përket realizimit të procedurave të prokurimit për mallra dhe shërbime specifike të autoriteteve kontraktuese është realizuar në tërësi.
- (7.3) Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit publik - KRPP, gjatë vitit 2018:
 - Ka kryer të gjitha monitorimet sipas kërkesës ose rastit (62 monitorime).
 - Ka bërë monitorimin e rreth 57% të publikimeve të njoftimeve për kontratë të ngritura në sistemin e Prokurimit elektronik (para se të bëhet publikimi i tyre), për të gjitha vlerat e kontratave pa përjashtim.
 - Ndërsa nuk ka pasur monitorim të menaxhimit të kontratës, kjo për shkak se në platformën elektronike ende nuk është funksionalizuar moduli i e-menaxhimit të kontratës.
- (7.4) Vetëdijesimi i publikut të gjerë lidhur me rregullat e prokurimit publik.- KRPP në bashkëpunim me IKAP dhe USAID-TEAM, gjatë kësaj periudhe raportuese ka mbajtur trajnime në katër tema të prokurimit publik. Në këto trajnime pjesëmarrës kanë qenë: Gjyqtar, Auditor të Brendshëm, Përfaqësues të Bizneseve, Drejtorë të Drejtorive Komunale, Zyrtarë që janë në komisione të hapjes dhe vlerësimit të ofertave, Drejtor të institucioneve shkollore të disa Komunave. janë trajnuar gjithsejtë 1070 pjesëmarrës.
- (7.5) Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit.- në mungesë të buxhetit nuk ka pasur trajnime të avancuara në fushën e prokurimit publik për zyrtarët e prokurimit gjatë vitit 2018.

3.3.2.- Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm

Fuqizimi i auditimit të brendshëm është me rëndësi sepse ndihmon menaxhmentin në arritjen e objektivave të organizatës.

Pas aprovimit të Ligjit për KBFP është përgatitur draft Rregullorja për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik dhe draft Udhëzimi Administrativ për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik. NJQH ka vazhduar me organizimin e trajnimeve teorike dhe praktike brenda programit të licencuar për certifikim të auditorëve të brendshëm. Si rezultat, brenda kësaj periudhe nga 153 auditorë të brendshëm që punojnë në sektorin publik, 139 ose 90.85% janë të certifikuar.


Aktivitetet e ndërmarra nga Ministria e Financave në prioritetin 8, kanë ndikuar në rritjen e përqindjes së numrit të auditorëve të brendshëm të certifikuar, ndërsa për indikatorin që ka të bëjë me përqindjen e zbatimit të rekomandimeve të zbatuara nga menaxhmenti është raportuar në takimin e Dialogut për MFP jetë 51.24%.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës	1. Përqindja e auditorëve të brendshëm të certifikuar	50%	80%	90%	65.33%	85%	90.85%
	2. Përqindja e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti.	51%	65 %	65 %	54.7%	48.59%	51.24%

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitete 8.1-8.5

Për arritjen e këtij Objektivi, janë paraparë 5 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në katër aktivitete 8.2 - 8.5, ndërsa progres i pjesshëm është evidentuar në aktivitetin 8.1. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 16 Prioriteti 8. Fuqizimi i auditimit të brendshëm



- (8.1) Ligji për KBFP gjatë muajit Maj 2018 është publikuar në gazetën zyrtare. Gjatë vitit 2018 janë përgatitë draft aktet nënligjore për KBFP si dhe janë organizuar trajnime për auditor të brendshëm por jo për aktet nënligjore për shkak të vonësës së aprovimit të Ligjit për KBFP.
- (8.2) Në bashkëpunim me USAID është përgatit Doracakut për auditimin e prokurim publik;
- (8.3) Nga 153 auditorë të brendshëm që punojnë në sektorin publik, 139 ose 90.85% janë të certifikuar,
- (8.4) Gjatë 2018 është mbajtur një punëtori me Autoritetin e Auditimit (AA) të fondeve të BE dhe ekipit të auditimit nga Kosova lidhur me auditimin e fondeve të BE. Pas kësaj punëtorie dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me AA të Malit të Zi bazuar në marrëveshjen 2014-2020 Auditimi i fondeve të BE-së për IPA/II konkretisht Projektet ndërkufitare me Malin e Zi për vitin 2018, është përfunduar nga ekipi NJQH. Gjatë kryerjes së auditimit ekipi ka marrë këshilla nga kolegët nga Mali i Zi. Ky proces është i vazhdueshëm. Gjithashtu në bashkëpunim me Autoritetin e Malit të Zi është përgatit plani strategjik dhe vjetor për të vazhduar me auditimin e fondeve të IPA II për projektin ndërkufitar me Malin e Zi për vitin 2019.
- (8.5) Raporti Vjetor për funksionimin e KBFP-së për vitin 2017 është përgatitë, kurse për 2018 do të përgatitet gjatë muajit Qershor 2019 sipas kërkesave të reja të Ligjit për KBFP.

3.3.3.- Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm

Prioriteti nëntë i shtyllës së tretë merret me auditimin e jashtëm dhe rezultati kryesor është zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik. Fuqizimi dhe zhvillimi i auditimit të jashtëm, bazuar në standardet ndërkombëtare profesionale dhe pavarësinë institucionale, është një nga prioritetet e reformës.

Sa i përket indikatorit të parë, përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave, të dhënat për Organizatat Buxhetore, është 22%. Ky indikator është pjesërisht i arritur në krahasim me cakun e përcaktuar për vitin 2018. Krahasuar me vitin bazë 2016 dhe raportimin në vitin 2017 vërehet përmirësim i dukshëm dhe trend pozitiv.

Sa i përket indikatorit të dytë, përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit, është arritur të zbatohen në masën 34% që është një rritje për 8% krahasuar me raportimin paraprak. Megjithatë mbetet nën cakun e përcaktuar për vitin 2018.

Sa i përket indikatorit të tretë, përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për vitin 2018 është 40%.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017 ⁹	Raporti 2018
Zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranuar ndërkombëtarisht	1. Përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.	10% ¹⁰	30%	50 %	14.14%	12,5%	22%
	2. Përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit	32%	45%	60%		26 %	34%
	3. Përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit	37%	25%	20%		38 %	40%

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitete 9.1-9.5

Për arritjen e këtij Objektivi, janë paraparë 5 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në të pesë aktivitetet 9.1 – 9.5. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

⁹ Përqindja paraqet rekomandimet e vitit 2015, e të zbatuara në vitin 2016

¹⁰ Vlera bazë i referohet vitit 2015

Grafiku 17 Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm



- (9.1) Sigurimi i pavarësisë institucionale.- ky aktivitet është realizuar dhe konsiderohet i përfunduar në vitin 2017.
- (9.2) Trajtimi i zbrazëtirës ndërmjet praktikës së auditimit të ZKA dhe të ISSA (SNISA).- sa i përket këtij aktiviteti është arritur progres i konsiderueshëm në lidhje me synimet e parapara. Është hartuar dhe miratuar “Plani Strategjik i Zyrës Kombëtare të Auditimit 2018-2021, si dhe Plani Operativ 2018-2019 për zbatimin e strategjisë. Ndërsa sa i përket synimit të dytë për zhvillimin e procedurave për kryerjen e auditimit përmes mjetit të kompjuterizuar të auditimit (CAAT), ZKA përdor softuerin për analizim të të dhënave “Nxjerrja dhe Analizimi Interaktiv i të dhënave - IDEA - Interactive Data Extraction and Analysis”. Ky softuer përdoret për qëllime mostrimi dhe rishikime analitike. Për më tepër, ZKA me mbështetjen e USAID TEAM është duke kryer procesin e Mapping-ut për një softuer të auditimit.
- (9.3) Përditësimi i Udhëzuesit për Auditimin e Rregullsisë.- para fillimit të sezonit auditues 2018/19 që fillon në shtator të vitit 2018, janë rishikuar Letrat e Punës dhe procedurat e auditimit. Po ashtu, manualit për auditimet e rregullsisë ju shtua një Shtojcë për auditimin e ndërmarrjeve publike dhe janë adaptuar letrat e punës me përkrahjen e projektit të financuar nga BE-ja. Ndërsa sa i përket ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit profesional, gjatë vitit 2018, janë organizuar trajnime të brendshme dhe ndërkombëtare kryesisht në fushën e auditimit. Në total 120 auditor kanë përfituar nga këto trajnime.
- (9.4) Zhvillimi i mëtejshëm i praktikës së auditimit të performancës në ZKA.- sa i përket këtij aktiviteti, gjatë vitit 2018, ka pasur programe të trajnimit për auditor të performancës nga ekspertët e SNAO (Swedish National Audit Office), të cilët kanë ofruar edhe mentorim të auditimeve të caktuara.
- (9.5) Përfshirja e Kuvendit.- ZKA ka organizuar tre tryeza të veçanta me anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe atij për Mbikëqyrje të Financave Publike ku në mënyrë të specifikuar janë trajtuar gjetjet dhe rekomandimet që kanë rezultuar nga veprimtaria audituese e që kanë për synim përmirësimin e menaxhimit të financave publike në Kosovë. Për më tepër KMFP, gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsejtë 26 mbledhje në kuadër të të cilave janë shqyrtuar 33 raporte të auditimit të lëshuara nga ZKA. Në të gjitha rastet kur në shqyrtim kanë qenë raporte të auditimit, ekipet e auditimit kanë përgatitur përmbledhje të shkurta për deputetët, anëtarë të KMFP-së dhe kanë ofruar këshillat dhe sqarimet e nevojshme sipas kërkesës. Përfaqësues të ZKA-së sipas ftesës kanë marrë pjesë në këto takime. Në disa raste KMFP ka rekomanduar disa raporte të auditimit për shqyrtim në seancë plenare me qëllim të rritjes së ndikimit për menaxhim më të mirë të parase publike nga institucione të caktuara. Ndërsa sa i përket synimit të dytë të këtij aktiviteti, në fillim të tetorit 2019, ZKA ka organizuar konferencën vjetore me temën “Roli dhe ndikimi i Institucioneve Supreme të Auditimit në rikthimin e besimit të publikut në sektorin publik”.

3.4. Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 4: Çështjet e ndërlidhura me MFP

Çështjet e ndërlidhura me MFP janë adresuar përmes tre Prioriteteve në SRMFP. Në këtë shtyllë reformat fokusohen në Përmirësimin e sistemeve të TI, Transparencën për buxhetin dhe Ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve në MFP.

3.4.1.- Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI


Prioriteti dhjetë (10) merret me përmirësimin e sistemeve të teknologjisë informative me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të financave publike. Për arritjen e këtij prioriteti, janë gjithsej 3 aktivitete të planifikuara. Gjatë vitit 2018, raportohet se ka përfunduar tërësisht integrimi i sistemeve kryesore të MF-së dhe të agjencive nën ombrellën e MF-së. Me këtë janë integruar 7 sisteme të TI.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Përmirësimi i sistemeve të TI që funksionojnë në Ministrinë e Financave për ta përmirësuar cilësinë e informatave financiare.	Numri i sistemeve të Integruara	0	5	7	Përgatitjet në vijim	Duke u bërë përzgjedhja e OE	7

Komenti për statusin e aktiviteteve 10.1-10.3

Për arritjen e këtij Objektivi, janë paraparë 3 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në një aktivitetet 10.1, ndërsa progres të pjesshëm në dy aktivitete 10.2 dhe 10.3. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 18 Prioriteti 10. Përmirësimi i sistemeve të TI



- (10.1) Integrimi i sistemeve të TI në MF dhe agjencitë e saja vartëse.- integrimi i sistemeve të TI-së është përbushur 100%. Për vitin 2018 kanë qenë të planifikuar integrimi i 5 sistemeve nga gjithsej 7. Aktualisht ka përfunduar integrimi i 7 sistemeve që është cak i synuar i strategjisë për vitin 2020. Sistemet e integruara janë: Sistemi i thesarit; sistemi i PIP; Sistemi BDMS; Sistemi i ATK-së (SIGTAS); sistemi i Doganave (Asycuda); sistemi i Tatimit në pronë (protax 2) dhe sistemi i Pagave (payroll).
- (10.2) Modernizimi i SIMFK, ngritja e kapaciteteve të teknologjisë informative të Thesarit.- Gjatë vitit 2018 është bërë shpallja e tenderit dhe përzgjedhja e kompanisë për ngritje të SIMFK-së duke u ndërlidh me RTGS.

- (10.3) Krijimi i një arkivi elektronik për Organizatat Buxhetore.- ka filluar pilotimi në disa OB për krijimin e arkivës elektronike. Gjatë vitit 2018 është bërë integrimi i pjesshëm i Arkivës elektronike në SIMFK për disa module (Urdhër blerjes dhe Shpenzimeve).

3.4.2.- Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin

Prioriteti i njëmbëdhjetë (11) ka të bëjë me sigurimin e transparencës së shpenzimit të fondeve publike, që për prioritet ka sigurimin e pajtueshmërisë së informatave për Buxhetin e Kosovës me FMN, përkatësisht me standardin GFSM 2014.

Edhe përkundër planifikimit, nuk është arritur të finalizohet rishikimi i planit kontabël brenda vitit 2018. Si pasojë, nuk është miratuar struktura e re kontabël e harmonizuar me IPSAS dhe GFS.


Në të njëjtën kohë, Thesari ka vazhduar me publikimin e rregullt të të dhënave mujore-serive kohore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën (2006-2018). Në ueb-faqen e MF është mundësuar publikimi dhe qasja në të dhëna fiskale në baza mujore, në format elektronik në Excel, duke ofruar transparencë të plotë për shfrytëzimin e parasë publike.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Sigurimi i pajtueshmërisë së informatave për buxhetin Kosovës me FMN standard. GFS 2014.	1. Buxhetimi dhe raportimi sipas tabelës së llogaritjeve që është në pajtim me GFS 2014	Ka filluar publikimi ¹¹	Planifikimi Buxhetor sipas GFS 2014	Standardi i GFS 2014 në përdorim	Dokumenti ndërlidhës në mes kodeve ekonomike, GFS 2014 dhe ESA 2010.	Pritet rishikimi i Rregullës financiare për Planin Kontabël të harmonizuar me GFSM dhe IPSAS.	Planifikimi Buxhetor sipas GFS 2014

Komenti për statusin e aktiviteteve 11.1-11.6

Për arritjen e këtij Objektivit, janë paraparë 6 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në tri aktivitete 11.1, 11.5 dhe 11.6, ndërsa në tri aktivitetet tjera 11.2, 11.3 dhe 11.4, raportohet për vonesa në zbatim. Grafiku në vijim pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 19 Prioriteti 11. Transparenca për buxhetin



¹¹Gjatë këtij viti për herë të dytë janë raportuar në GFS (të hyrat dhe shpenzimet) dhe publikuar në web faqen e MF-së, dhe të dhënat për Qeverinë e Përgjithshme sipas GFS.

(11.1) Modifikimi i SIMFK për ta mundësuar përgatitjen e automatizuar të raporteve të buxhetit në pajtim me GFSM 2014.- është krijuar vegël e veçantë për transformim të të dhënave nga kodet aktuale në planin kontabël (SIMFK) në formatin e kërkuar sipas GFSM 2014.

(11.2) Rishikimi i planit kontabël të Qeverisë.- në vitin 2018 nuk është rishikuar.

(11.3) Miratimi i një strukture të re kontabël të harmonizuar me IPSAS dhe GFS dhe të inkorporohet në SIMFK.- nuk ka pas progres gjatë vitit 2018.

(11.4) Përkthimi i Manualit për statistikat financiare qeveritare dhe trajnimi i zyrtarëve për strukturën e re kontabël.- ky aktivitet ka vonesë në zbatim për shkak se ndërlidhet me rishikimin e Planit Kontabël të Qeverisë.

(11.5) Publikimi i serive kohore të të hyrave dhe shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë.- janë publikuar seritë kohore mujore në baza të rregullta.

(11.6) Është publikuar informatori për qytetarë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2018.- informatori për qytetarët për Buxhetin e Kosovës për vitin 2018 është i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Financave (në linkun <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1.33>, në të tri gjuhët). Për më shumë gjatë vitit 2018, në bashkëpunim me GIZ, është lancuar Portali i transparencës (<https://ptmf.rks-gov.net/>).

3.4.3.- Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP

Për arritjen e prioritetit në lidhje me ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve në MFP, janë ndërmarr disa iniciativa, të cilat nuk kanë rezultuar me sigurimin e mjeteve për zbatimin e Studimit të Fizibilitetit, i cili do të sugjeronte zgjidhjen më të mirë për këtë Prioritet. Për më shumë edhe vonesa e Mbështetjes Buxhetore Sektoriale ka ndikuar në vonesën në zbatim. Me buxhetin e vitit 2019 janë ndarë mjetet buxhetore për realizimin e Studimit të fizibilitetit.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raporti 2016	Raporti 2017	Raporti 2018
Arritja e një mënyrë sistematike, e qëndrueshme dhe e integruar e ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë në Menaxhimin e Financave Publike duke e shfrytëzuar ekspertizën vendore, të administratës publike dhe atë të jashtme.	1. Numri i programeve të trajnimit për MFP			X programe nga fusha e MFP	Ngritja e kapaciteteve si më parë	Në pritje të zbatimit të Studimit të fizibilitetit	Janë siguruar mjetet në 2019
	2. Numri i zyrtarëve të trajnuar në fushën e MFP			Xx zyrtarë të trajnuar në MFP	Ngritja e kapaciteteve si më parë	Në pritje të zbatimit të Studimit të fizibilitetit	Fermat e referencës pas studimit

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitete 12.1-12.3

Për arritjen e këtij Objektivi, janë paraparë 3 aktivitete. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar vonese në zbatim në të tri aktivitetet 12.1, 12.2 dhe 12.3. Grafiku në vijim pasqyron gjendjen në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2018.

Grafiku 20 Prioriteti 12. Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP



- 12.1 Zhvillimi i studimit të fizibilitetit, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime.- termat e Referencës për Studimin e Fizibilitetit, edhe pse të hartuara, nuk janë finalizuar me studim për shkak se nuk është arritur të sigurohen mjetet financiare. Mjetet janë ndarë në buxhetin 2019, pritet iniciimi i këtij veprimi së shpejti. Ky aktivitet është analizuar dhe riformuluar me rastin e rishikimit të Planit të Veprimit 2019-2020.
- 12.2 Përgatitja e Kurrikulës në Menaxhimin e Financave Publike.- pritet të zhvillohet pas përfundimit të Studimit të fizibilitetit.
- 12.3 Ofrimi i trajnimeve në fushën e MFP.- nëse dy aktivitetet paraprake zhvillohen, atëherë pason hartimi i Kurrikulës në vitin 2020.

4. Veprimet Prioritare për vitin e ardhshëm bazuar në sfidat e identifikuar dhe Rekomandimet për tejkalimin e sfidave

Ky seksion prezanton hapat e ardhshëm dhe rreziqet e shoqëruara me veprimet që pritet të ndërmerren, me qëllim të zbatimit të Strategjisë. Ministria e Financave në bashkëpunim me institucione e përfshira ka ndërmarr aktivitete që dalin nga zbatimi i Strategjisë për reformën e MFP-së (SRMFP) dhe plotësimin e kërkesave tjera që dalin nga ky proces. Në këtë drejtim kanë qenë edhe hapat për Rishikim të Planit të Veprimit të SRMFP për vitet 2019-2020.

Grupi Koordinues i MFP gjatë vitit 2018, i përkrahur me ekspertizë nga SIGMA, ka bërë analizën e dy Raporteve vjetore dhe dy Raporteve Gjashtë mujore të hartuara në kuadër të zbatimit të SRMFP. Gjithashtu janë analizuar vlerësimet dhe rekomandimet e partnerëve zhvillimor. Kriteret e analizës kanë qenë të bazuar në relevancën e aktiviteteve, por edhe të Indikatorëve ekzistues të Planit të Veprimit 2016-2018. Gjithashtu, është marr në konsideratë edhe zbatimi i aktiviteteve, duke i larguar ato që tashmë janë evidentuar si të përfunduara.

Orientimi fillestar ka qenë që të mos ndryshohen prioritetet dhe indikatorët e strategjisë, në mënyrë që të ruhet vazhdimësia si dhe natyra sfiduese e strategjisë. Fillimisht analiza, por më vonë edhe diskutimet dhe sugjerimet e dala nga Takimi i Dialogut për MFP të mbajtur më 27 Nëntor 2018, kanë shtyrë që tek disa Prioritete të rishikohen edhe indikatorët. Indikatorët e vlerësuar si jo relevant janë zëvendësuar sipas mundësisë me Indikatorët Variabil që kanë dalë nga Marrëveshja Financiare për Mbështetje të MFP (indikator 1, 2, 6, 11).

Për më shumë GK për MFP ka rishikuar edhe Pasaportën e Indikatorëve për Vitet 2019-2020, Kornizën për vlerësimin e rrezikut – SRMFP 2019-2020 si dhe Kornizën e menaxhimit të Riskut të SRMFP sipas aktiviteteve 2019-2020.

Hapat e ndërmarrë në rishikimin e Planit të Veprimit janë pjesë përbërëse e Strategjisë së Reformave në MFP (SRMFP) 2016-2020, dhe së bashku me dokumentet përcjellëse si Pasaportën e Indikatorëve 2019-2020, Kornizën për vlerësimin e rrezikut – SRMFP 2019-2020 dhe Kornizën e Menaxhimit të Riskut të SRMFP sipas aktiviteteve 2019-2020 sigurojnë përkushtimin dhe vazhdueshmërinë e zbatimit të Strategjisë.